



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E BUJQESE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
Arkivi Qendror - Centralni Arhiv - Central Archive

Nr./Br./No. 610  
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 51  
Data/Datum/Date: 21/03/2015  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të Nenit 145 (parografi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në Nenin 8 (parografi 1.4), Shtojcën 14 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrite (datë 22.03.2011), Nenit 38, parografi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr.15, 12.09.2011), në mbështetje të Nenit 15, parografi 3 të Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.56, 27 Korrik 2009) si dhe Nenit 16 parografi 2, Nenit 17, parografi 3 të Ligjit Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16, Tetor 2012, nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.01/2015  
PËR MASAT DHE KRITERET E PËRKRAHJES NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM  
RURAL PËR VITIN 2015**

KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1  
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen parimet, kushtet, procedurat dhe kriteret e pranueshme për zbatimin e masave të miratuara për vitin 2015 në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës (PZHRB) 2014 – 2020.

Neni 2  
Fushëveprimi

1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton përkrahjen për masat dhe nën masat e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural:
  - 1.1. Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore;
  - 1.2. Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;
  - 1.3. Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve;
  - 1.4. Ujitjen e tokave bujqësore.
2. Përkrahja e investimeve për masat si në paragrafin 1 të këtij Neni bëhet tek:
  - 2.1. Sektori i pemëve;
  - 2.2. Sektori i perimeve dhe serrave, duke përfshirë edhe patatet;
  - 2.3. Sektori i qumështit;
  - 2.4. Sektori i mishit;
  - 2.5. Sektori i vezëve;
  - 2.6. Sektori i rrushit;
  - 2.7. Sektori i përpunimit të qumështit
  - 2.8. Sektori i përpunimit të mishit
  - 2.9. Sektori i përpunimit të pemëve
  - 2.10. Sektori i përpunimit të perimeve
  - 2.11. Sektori i prodhimit të verës
  - 2.12. Sektori i bletarisë, prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të mjaltit;
  - 2.13. Sektori për grumbullimin dhe përpunimin e prodhimeve jo drusorë të malit dhe marketingu i tyre;
  - 2.14. Përkrahja për përpunimin e prodhimeve bujqësore, të kultivuara dhe marketingu i tyre;
  - 2.15. Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre;
  - 2.16. Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë.
  - 2.17. Ujitia e tokave bujqësore

Neni 3  
Shtrirja gjeografike

Shtrirja gjeografike për të gjitha masat si në paragrafin 1 dhe 2 të Nenit 2 do të jetë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 4  
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:
  - 1.1. “**Kërkesa për pagesë**” - nënkupton parashtrimin e kërkesës së pagesës së shpenzimeve të paraqitura dhe të dëshmuara me fatura valide për shpenzimet e realizimit të projektit pas aprovimit për mbështetje;

- 1.2. “**Masa 101**”, nënkuption investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, sipas PBZHR-së 2014-2020;
- 1.3. “**Masa 103**”, nënkupton investimet ne asetet fizike ne përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, sipas PZHRB-së 2014-2020;
- 1.4. “**Masa 302**”, nënkupton diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve, sipas PBZHR-së 2014-2020;
- 1.5. “**Përkrahje**” – nënkupton përkrahjen financiare për zbatimin e Masës 101,103,302 dhe Ujitjen e Tokave Bujqësore të PBZHR-së 2014-2020;
- 1.6. “**Aplikues**”– nënkupton personin i cili aplikon për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural.
- 1.7. “**AZHB**” – Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë

KREU II  
MASA 101  
INVESTIMET NË ASSETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE

Neni 5  
Përfituesit

#### 1. Përfituesit përfundimtar

1.1. Përfitues përfundimtar për Masën 101 janë fermerët, sipas përkufizimit në Ligjin Nr.03/l-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe ndërmarrjet e tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermave.

#### 2. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë

##### 2.1. Aplikuesi i pranueshëm konsiderohet aplikuesi që përmbush këto kritere:

- 2.1.1. Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë mbi 18 vjeç, por jo më i vjetër se 60 vjet;
- 2.1.2. Aplikuesit duhet të përmbushin detyrimet tatimore, personat fizik tatimin në pronë kurse personat juridik tatimin në fitim;
- 2.1.3. Përfituesi i projekteve të zhvillimit rural duhet t'i ketë paguar me rregull obligimet tatimore gjatë 5 vjetëve pas implementimit të investimit, aq sa zgjatë periudha monitoruese;
- 2.1.4 Përfituesit e projekteve të zhvillimit rural duhet t'i mirëmbajnë investimet e tyre gjatë 5 vjetëve pas implementimit të investimit, aq sa zgjatë periudha monitoruese.
- 2.1.5. Nëse nuk i mirëmbajnë investimet, përfituesi obligohet të kthejë përkrahjen publike.

## 2.2. Standardet kombëtare

2.2.1. Standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në Udhëzuesin për Aplikues për Masën 101, duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe do të verifikohen me kontrollin e personit zyrtar në vendin e investimit.

## 2.3. Qëndrueshmëria ekonomike

2.3.1. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë deri 20,000 euro, aplikuesi duhet të dorëzojë një projekt-propozim sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (më tutje MBPZHR);

2.3.2. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 euro, aplikuesit duhet të dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit të MBPZHR;

2.3.3. Modeli për projekt-propozim teknik dhe për planin e biznesit publikohet në webfaqen e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë.

## 2.4. Kritere tjera të pranueshmërisë

2.4.1. Përfituesit e projekteve të investimeve të pranueshme me vlerë më të madhe se 50.000 €, brenda 10 ditësh pas nënshkrimit të kontratës me Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të regjistrojnë ndërmarrjen e tyre dhe të gjitha investimet dhe shpenzimet duhet të faturohen në emër të ndërmarrjes;

2.4.2. Përfituesit të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe t'i dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga për së paku muajin e fundit para kërkesës për pagesën e fundit;

2.4.3. Përfituesit janë të detyruar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese;

2.4.4. Investimet e finançuara nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural 2015 nuk bënë të jenë të finançuara edhe nga zyra e BE-së apo ndonjë donator tjetër publik. Nëse përfituesi ka tentuar të përfitoj përkrahje nga dy burime publike, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet të kthej mjetet e marra si dhe do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin;

2.4.5. Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në mënyrë të rregullt;

2.4.6. Aplikuesi duhet të dëshmojë njohuri të mjaftueshme bujqësore duke plotësuar një nga kushtet si ne vijim:

2.4.6.1. Të kenë së paku shkollën e mesme dhe dy vjet përvojë në lëmin në të cilën aplikojnë;

2.4.6.2. Nëse nuk kanë përvojë të mjaftueshme duhet të bëjnë një deklaratë me shkrim me të cilën zotohen se do të ndjekin kurse trajnimi me së paku 20 orë mësimi, në fushën për të cilën aplikojnë. Orët e mësimit do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit;

2.4.6.3. Aplikuesit me shkollë të mesme bujqësore, studentë në vitin e dytë ose tretë të Fakultetit të Bujqësisë ose arsimim të lartë në fushën e bujqësisë nuk janë të obliguar të ndjekin trajnimet nga nënparagrafi 2.4.6.2 të këtij Neni;

2.4.6.4. Në rastin e ndërmarrjeve bujqësore, kërkesat aplikohen për menaxherin e ndërmarrjes.

2.4.7. Në rast të personave juridik, së paku një person i ndërmarrjes që e përfaqëson ekonominë bujqësore duhet të jetë i punësuar me kontratë jo më të shkurtër se 5 vjet;

2.4.8. Përvojë e mjaftueshme konsiderohet puna në ndërmarrje bujqësore që mund të dëshmohet me vërtetim ose i regjistruar në Regjistrin e Fermës për së paku 2 vjet ;

2.4.9. Për projektet e ndërtimit, aplikantët me rastin e aplikimit, duhet të dorëzojnë:

2.4.9.1. Kopjen e skicave të objektit dhe një parallogaritje të shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;

2.4.9.2. Pëlqimin e komunitetit (në rastet e përcaktuara me Ligj);

2.4.9.3. Kopjen e planit të parcelës ku bëhet investimi;

2.4.9.4. Fletën poseduese ose në rast se toka është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet për ngastrën ku do të bëhet ndërtimi;

2.4.9.5. Pëlqimin urbanistik të komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit përfituesi do të marrë leje ndërtimi. Nëse fermerët nuk mund të marrin kopjen e planit dhe fletën poseduese të tokës sipas nën paragrafit 2.4.9.3 che paragrafit 2.4.9.4 të këtij nenit, për tokën e cila gjendet në komasacion, por për të cilën posedojnë aktvendime të ligjshme nga kadastra për sipërfaqe përkatëse, ju lejohet aplikimi për masat dhe kriteret në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2015, me aktvendimet përkatëse të komasacionit;

2.4.10. Para kërkesës për pagesë në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të dorëzojnë:

2.4.10.1. Lejen për ndërtim nga organi kompetent i komunës, vetëm për stalla dhe depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve;

2.4.10.2. Vlerësimin e ndikimit në mjedis, në rastet e përcaktuara me ligj.

2.4.11. Në rast të ndërtimit / renovimit të objekteve, të ngritjes së pemishtes, vreshtit dhe vendosjes së sistemit të ujitjes në toka të marra me qira, kontrata për qiramarrje duhet të jetë për së paku 10 vjet dhe duhet t'i bashkëngjitet pëlqimi i pronarit (qiradhënësit) i vërtetuar te noteri, për investimin që do të bëhet në tokën e tij;

2.4.12. Pëlqimi i pronarit mund të përfshihet në kontratën për qiramarrje.

## 2.5. Lista kontrolluese për përzgjedhje mjedisore

2.5.1.Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, para nënshkrimit të kontratave për financim të projekteve për zhvillim rural, projektet e përzgjedhura do t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit mjedisor, sipas Listës Kontrolluese për Përzgjedhje Mjedisore .

2.5.2.Lista kontrolluese do të plotësohet nga AZHB duke dhënë informata shtesë për rubrikën "Karakteristikat specifike" për t'i sqaruar përgjigjet e dhëna.

2.5.3. Nëse një apo më shumë përgjigje në listën kontrolluese është pozitive, atëherë projekti do të ketë ndikim në mjedis, dhe si i tillë kërkon përgatitjen e Planit për Menaxhim Mjedisor (më tutje PMM).

2.5.4. Masat zbutëse të parashikuara në listën kontrolluese do të janë pika udhëzuese për përgatitjen e PMM.

2.5.6. Procesi i aprovimit të projektit kërkon që të gjitha masat zbutëse të propozuara të pranohen dhe të miratohen për zbatim nga ana e aplikuesit.

2.5.7.Përgatitja e PMM do të jetë obligim i vetë aplikuesit, ndërsa shpenzimet për përgatitjen e tij do të konsiderohen si shpenzime administrative.

### 3. Investimet e pranueshme janë:

3.1. Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë futur në Listën e Investimeve të pranueshme për masën 101 të paraqitura në Udhëzuesin për Aplikues;

3.2. Shpenzimet maksimale të pranueshme për periudhën e zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014 – 2020 për Masën 101 është 500,000 € për përfitues;

3.3. Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt - propozimit nuk mund të tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme;

3.4. Në rast të investimeve që parashohin ndërtim të stallave apo depove për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

### 4. Shkalla e përkrahjes publike:

4.1. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj Mase është 10,000 €, përveç projekteve për pemë manore, ku vlera minimale e projektit është 3,000 €;

4.2. Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 120,000 €.;

4.3. Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;

4.4. Përkrahje shtesë prej 10% jepet për investime në zonat malore dhe 5% për fermerë të rinj nën moshën 40 vjeç.

## 5. Afati i implementimit

5.1. Afati i implementimit të projekteve të kësaj mase është 120 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, përveç për sektorin e rrushit, për projektet e të cilët afati i implementimit është 300 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, për shkak të periudhës pranverore së mbjelljes së rrushit.

5.2. Pas periudhës prej 120 ditëve, respektivisht 300 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.

5.3. AZHB mund të zgjasë afatin e implementimit, nëse ka arsyë të forta për këtë, siç është respektimi i periudhave vegetative te bimët, si periudha e mbjelljes së pemëve drufrutore, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi të huaj, etj.

### KREU III NËNMASAT III.I. SEKTORI I PEMËVE

#### Neni 6 Kriteret e pranueshmërisë

1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për sektorin e pemëve: molla, dardha, kumbulla, vishnja, dredhëza, mjedra, boronica dhe manaferra janë:

1.1. Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikanti duhet të dëshmojnë posedimin e sipërfaqes bujqësore, në pronësi apo të marra me qira për së paku 10 vjet dhe të regjistruar ne Regjistrin e Fermave prej së paku 1 hektarë për pemë drufrutore: molla, dardha, kumbulla, vishnja ose 0.25 hektarë për pemë manore / pemë të imta: dredhëza, mjedra, boronica dhe manaferra;

1.2. Madhësia minimale e ngastrës për pemë manore është 0,1 hektarë dhe për pemë drufrutore 0,35 hektarë;

1.3. Në rast të investimeve në makineri bujqësore dhe pajisje ose investime në ndërtim dhe përmirësim të objekteve, investimi duhet të përputhet me kapacitetet prodhuese;

1.4. Përfituesi për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përbush kriterin CAC (Conformity Agrar Certificion ) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.

1.5. Fidanët e mbjellur të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues. Përfituesit për ngritjen e pemishteve me pemë manore duhet t'i

ruajnë etiketat e fidanëve të blerë me tufa për t'i paraqitur para kontrolluesve të AZHB-së me rastin e kontrollit.

## 2. Investimet e pranueshme në sektorin e pemëve janë:

- 2.1. Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me sipërfaqe minimale prej 1 ha për pemë drufrutore dhe 0,25 ha për pemë manore;
- 2.2. Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë sipas praktikave efikase të ujitjes;
- 2.3. Prodhimi i energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme;
- 2.4. Investimet në vendosjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- 2.5. Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- 2.6. Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave dhe objekteve për vendosjen e produkteve për mbrojtje të bimëve dhe plehra artificiale.

## 3. Kriteret e përzgjedhjes:

Tabela Nr.1 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e pemëve

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria			Pikë
1	Kapaciteti prodhues: sipërfaqe që do të ngrihet. Në rast të investimit në infrastrukturë të pemishtes, depo, ujitje, mbrojtje kundër breshrit dhe makineri, pikat merren varësisht prej sipërfaqes ekzistuese apo / dhe asaj që do të ngrihet	Pemë të imëta	Pemë drufrutore dhe arrore		
		> 1 ha	> 5 ha	45	
		$\geq 0.75 \leq 1$ ha	$\geq 4 \leq 5$ ha	42	
		$\geq 0.5 < 0.75$ ha	$\geq 3 < 4$ ha	39	
		$\geq 0.35 < 0.5$ ha	$\geq 2 < 3$ ha	37	
		$\geq 0.25 < 0.35$ ha	$\geq 1 < 2$ ha	35	
2	Cilësia e materialit fidanor	Investim ne fidanë të prodhua dhe të certifikuara në shtete të BE			5
3	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata për dorëzim për së paku 50% të prodhimit (nuk kërkohen për aplikuesit për ngritje të pemishteve të reja – ata i marrin 8 pikë nga ky kriter)			8
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)			5
5	Statusi pronësor i tokës ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit			5

6	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - më shumë se 4 vende pune = 10 pikë	Max 10
7	Pozita e investimit	Investimi në viset malore	5
8	Përkatje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit	10
9	Arsimimi	Diplomë përkatëse universitare në bujqësi / teknologji e ushqimit Shkolla e mesme bujqësore ose student i Fakultetit të Bujqësisë, viti i dytë ose i tretë	5 3
10	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ (maksimum)			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

### III.II. SEKTORI I PERIMEVE DHE SERRAVE PËRFSHIRË PATATET

Neni 7

Kriteret e pranueshmërisë

#### 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

1.1. Në momentin e aplikimit për investime në depo për pemë dhe perime / patate, aplikantët duhet të dëshmojnë posedimin e sipërfaqeve të tokës së punueshme, në pronësi apo të marra me qira, për së paku 10 vjet dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermave prej së paku 2 ha;

1.2. Në rast të investimeve në ndërtimin e serrave të reja permanente, ekonomia bujqësore (ferma) duhet të dëshmojë se ka së paku 0.10 ha tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave.

#### 2. Investimet e pranueshme:

2.1. Investimet në ndërtimin e serrave të përhershme për pemë të imta, perime apo fidane me madhësi minimale prej 0.1 ha;

2.2. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërritshme;

2.3. Blerja dhe instalimi i paisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike;

2.4. Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes;

2.5. Ndërtimin e objekteve për trajtim pas vjeljes (klasifikim, paketim, etiketim) dhe për ruajtje të prodhimit, si dhe depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.

### 3. Kriteret e përzgjedhjes:

Tabela Nr.2 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e perimeve dhe serrave (përfshirë pataten)

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Lloji i investimit	1. Ndërtimi i serrave me infrastrukturë komplete	55
		2. Ndërtim i depove për trajtim pas vjeljes (madhësia e depos duhet të përputhet me prodhimin e pemëve dhe perimeve nga aplikuesi)	45
2	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata për dorëzim për së paku 50% të prodhimit <i>(Nuk u kërkohet aplikuesve për depo dhe as aplikuesëve të rinj- ata i marrin 8 pikë nga ky kriter)</i>	8
3	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)	5
4	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2-3 vende pune = 7 pikë - më shumë se 4 vende pune = 10 pikë	Max. 10
5	Pronësia mbi tokën	Toka në emër të aplikuesit	5
6	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vjetët e fundit	10
7	Arsimimi	Diplomë përkatëse universitare në bujqësi / teknologji të ushqimit	5
		Shkolla e mesme bujqësore ose student i Fakulteti të Bujqësisë, viti i dytë ose i tretë	3
8	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ (maksimum)			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuarë më herët.

### III.III. SEKTORI I MISHIT

Neni 8

Kriteret e pranueshmërisë

#### 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

- 1.1. Për investime në sektorin e mishit (majmja e viçave dhe zogjëve te pulës), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë kafshë në momentin e aplikimit, por zotohen se do të kenë së paku 20 krerë viça me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së, ose 5.000 zogj të pulës, dhe këto duhet ti dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë para paraqitjes së kërkesës për pagesën e fundit;
- 1.2. Ekonomitë bujqësore që aplikojnë për ndërtimin e stallës për viça, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj;
- 1.3. Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, në momentin e aplikimit, aplikuesi për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se posedojnë së paku 0.3 hektarë të tokës bujqësore në pronësi apo të marrë me qira për se paku dhjetë vjet (nuk vlen për zogj të pulës).
- 1.4. Në momentin e aplikimit, aplikuesit për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se posedojnë së paku 0.3 hektar të tokës bujqësore për kokë viçi, në pronësi apo të marrë me qira për së paku 3 vjet.

#### 2. Investimet e pranueshme:

- 2.1. Ndërtimi, riparimi, zgjerimi i stallave, objekte përcjellëse (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit) dhe infrastrukturës në fermë (furnizim me ujë në nivel ferme);
- 2.2. Investimet në pajisje për rritje të zogjëve njëditor (pajisje për ngrohje, për ushqim furnizim me ujë);
- 2.3. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërritshme;
- 2.4. Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- 2.5. Investimet në makineri bujqësore dhe paisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrije;
- 2.6. Investimet për pastrimin, largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- 2.7. Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar me kapacitet i cili së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

#### 3. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.3 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e mishit

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
----	-------------------	---------------------	-------

1	Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët merren nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 30 pikë)	a) Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallës (gropa septike është e detyrueshme)		30
		b) Makineri dhe / ose përmirësimi i infrastrukturës së jashtme (depo e silazhit, depo e sanës)		25
2	Kapaciteti prodhues (numri i kafshëve) pas realizimit të projektit	Gjedhë	Broiler (zogj)	
		$\geq 20 < 50$ krerë	$\geq 5000 < 10000$ krerë	20
		$\geq 50$ krerë	$\geq 10000$ krerë	10
3	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata për dorëzim për së paku 50% të prodhimit		8
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)		5
6	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2-3 vende pune = 7 pikë - më shumë se 4 vende pune = 10 pikë		Max. 10
7	Pozita e investimit	Investimi në viset malore		5
8	Përkatje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit		10
9	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / veterinari / teknologji të ushqimit		5
		Shkolla e mesme bujqësore ose student i Fakultetit të Bujqësisë, viti i dytë ose i tretë.		3
10	Statusi pronësor i tokës ku bëhet investimi	Toka në emër të investuesit		5
11	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër		2
<b>GJITHSEJ (maksimum)</b>				<b>100</b>

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

### III.IV. SEKTORI I QUMËSHTIT

Neni 9

Kriteret e pranueshmërisë

## 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

- 1.1. Në momentin e aplikimit, aplikuesi për investime në sektorin e prodhimit të qumështit duhet të ketë së paku 15 lopë qumështore, ose 150 dele apo 100 dhi në prodhimtari aktive, të regjistruara në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin për Identifikim dhe Regjistrim të Kafshëve në AUV;
- 1.2. Ekonomitë bujqësore që aplikojnë për ndërtimin e stallës, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj;
- 1.3. Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesi duhet të dëshmoi posedimin e të paktën 0,5 ha të tokës bujqësore për çdo krerë lope apo 0,05 ha për kokë deleje / dhie, në pronësi apo të marra me qira së paku 10 vite.

## 2. Investimet e pranueshme:

- 2.1. Ndërtimi, renovimi, zgjerimi i stallave, objektet përcjellëse (deponi e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit, mjeltore) dhe infrastrukturës në fermë (furnizim me ujë në nivel ferme);
- 2.2. Investimet në modernizimin e mjeljes dhe pajisjeve për ftohje si pajisjet për mjelje, ruajtje të qumështit përfshirë dhomat e ruajtjes së qumështit, laktofrizat;
- 2.3. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme;
- 2.4. Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- 2.5. Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrije;
- 2.6. Investimet për pastrimin / largimin e plehut organik dhe deponimin e tij;
- 2.7. Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar me kapacitet i cili së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

## 3. Kriteret e përgjedhjes

Tabela Nr.4 Kriteret e përgjedhjes për sektorin e qumështit

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikë
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit nga pika a) dhe b), pikët merren nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 35 pikë)	a) Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallave dhe depos së plehut	35
		b) Makineri dhe / ose përmirësimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme (depo e silazhit, depo e sanës)	30
2	Kapaciteti prodhues: numri i kafshëve në prodhimtari aktive para aplikimit	Lopë qumështore	Dele / dhi qumështore
		$\geq 15 < 25$ krerë	$\geq 150 / 100 < 300$ krerë
		$\geq 25$ krerë	$\geq 300$ krerë

3	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës	8
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)	5
6	Punësimi	Aplikuesi do te krijoje vendeve të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - më shumë se 4 vende pune = 10 pikë	Max. 10
7	Vendndodhja e investimit	Investimi në viset malore	5
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit	10
9	Arsimimi	Diplomë përkatëse universitare në bujqësi / veterinari / teknologjitet ushqimit	5
		Shkolla e mesme bujqësore ose student i Fakultetit të Bujqësisë, viti i dytë ose i tretë	3
10	Statusi pronësor i tokës ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5
11	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJT (maksimum)			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

### III.V. SEKTORI I RRUSHIT

Neni 10

Kriteret e pranueshmërisë

#### 1. Kriteret e veçanta te pranueshmerisë

1.1. Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë posedimin e tokës bujqësore në pronësi apo të marrë me qira, të regjistruar në Regjistrin e Fermës, për së paku 10 vjet dhe atë 0,5 hektarë përrush të tryezës ose 1 hektarë përrush të verës. Sipërfaqja minimale e ngastrës është 0,2 hektarë;

1.2. Në rast të investimeve në mekanizm dhe pajisje për kultivim dhe vjelje si dhe depo përrajtim pas vjeljes, aplikuesi duhet të dëshmoj se posedon së paku 4 hektarë me vreshta, në pronësi apo të marrë me qira, të regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës;

1.3. Përfituesit për ngritje të vreshtave të reja, para kërkësës për pagesë, mund blejnë vetëm fidanë të importuar nga vendet e BE-së dhe duhet të dorëzojnë

kopjen mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën mbi prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.

## 2. Investimet e pranueshme:

- 2.1. Investimet në ngritjen, modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, zëvendësim) për rrush tryze dhe rrush vere me madhësi minimale prej 0.5 ha për rrush të tryezës dhe 1 ha hektarë pér rrush të verës;
- 2.2. Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes sipas praktikave efikase të ujitjes;
- 2.3. Investimet në vendosjen e plasmasit pér rrush të tryezës;
- 2.4. Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtitishme;
- 2.5. Investimet në vendosjen e rrjetave pér mbrojtje nga breshëri;
- 2.6. Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe rrethoja;
- 2.7. Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje pér vreshta, makineri pér mbrojtje të bimëve, pér plehërim, pér vjelje dhe trajtim pasvijeljes;
- 2.8. Atyre që kanë mbi 4 ha sipërfaqe vreshta u lejohet edhe aplikimi pér ndërtimin e objekteve pér veprimet pas vjeljes si depo ftohëse, makineri pér klasifikim, pastrim, paketim etj;
- 2.9. Objekte pér mbajtje të makinerisë bujqësore dhe pajisjeve si dhe ndërtimi i depove pér produktet pér mbrojtje të bimëve dhe plehrat artificiale.

## 3. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.5 Kriteret e përzgjedhjes pér sektorin e rrushit

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Kapaciteti prodhues: Sipërfaqe që do të ngrihet, në rast të investimit pér depo dhe makineri, pikët merren varësisht prej sipërfaqes ekzistuese apo / dhe asaj që do të ngrihet.	> 4 hektarë rrush	50
		$\geq 3 \leq 4$ hektarë rrush	47
		$\geq 2 < 3$ hektarë rrush	44
		$\geq 1 < 2$ hektarë rrush	42
		$\geq 0.5 < 1$ hektar rrush	40
2	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata pér dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës (nuk kërkohen pér aplikuesit pér ngritje të vreshtave të reja dhe i marrin 8 pikë)	8
3	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% investimit të pranueshëm)	5
4	Statusi pronësor i tokës ku	Toka në emër të aplikuesit	5

	bëhet investimi		
5	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vendeve të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - më shumë se 4 vende pune = 10 pikë	Max. 10
6	Vendndodhja e investimit	Komuna: Rahovec, Suharekë, Prizren, Gjakovë, Malishevë	5
7	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit	10
8	Arsimimi	Diplomë përkatëse universitare në bujqësi / teknologji të ushqimit	5
		Shkolla e mesme bujqësore ose student i Fakultetit të Bujqësisë, viti i dytë ose i tretë	3
9	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ maksimum			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

### III.VI. SEKTORI I VEZËVE

Neni 11

Kriteret e pranueshmërisë

#### 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

1.1. Aplikuesi për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 6,000 e më së shumti 50,000 pulave vojse në prodhimtari aktive, të regjistruar në Regjistrin e Fermës;

1.2. Ndërmarrjet me më shume se 50,000 pula vojse mund të aplikojnë vetëm për makineri dhe pajisje në kuadër të kësaj nënmasë;

#### 2. Investimet e pranueshme janë:

2.1. Ndërtimi, renovimi, zgjerimi i stallave;

2.2. Investime në infrastrukturë të brendshme (sistemi i të ushqyerit, ujëpirëset dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehat, klasifikim të vezëve);

2.3. Investime në kafaze, vetëm sipas standardeve të BE-së;

2.4. Ndërtimi dhe përmirësimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet përgatitje të ushqimit, manipulim, paketim dhe ruajtje te vezëve;

- 2.5. Investimet në pajisje eficiente për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme;
- 2.6. Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar të shpezëve me kapacitet i cili së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

### 3. Kriteret përzgjedhjes

Tabela Nr.6 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e vezëve

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit nga më shumë se një pikë (a, b, c, d), pikët merren nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 20 pikë)	a) Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallave	20
		b) Përmirësimi i infrastrukturës së fermës	15
		c) Ndërtimi i depove të ushqimit / trajtimit	10
		d) Makineri dhe pajisje bujqësore	5
2	Kapaciteti prodhues: numri i pulave vojse	$\geq 6000 < 20000$ pula vojse	15
		$\geq 20000 \leq 50000$ pula vojse	
		> 50000 pula, vetëm për investime nën b), c) dhe d) të kriterit të parë	10
3	Mënyra e mbajtjes së pulave	Pa kafaz, në natyrë	10
		Pa kafaz, në dysheme	8
		Kafaz sipas standardeve të BE-së	5
4	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës	8
5	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)	10
6	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - më shumë se 4 vende pune = 10 pikë	Max. 10
7	Vendndodhja e investimit	Investimi zbatohet nën zonat malore	5
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit	10

9	Arsimimi	Diplomë përkatëse universitare në bujqësi / veterinari / teknologji të ushqimit	5
		Shkolla e mesme bujqësore ose student i Fakultetit të Bujqësisë, viti i dytë ose i tretë	3
10	Statusi pronësor i tokës ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5
11	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ (maksimum)			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

KREU IV

MASA 103

**INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E  
PRODUKTEVE BUJQËSORE**

Neni 12

Përfituesit

1. Përfituesit përfundimtar mund të jenë:

- 1.1. Ndërmarrjet e përpunimit të qumështit, mishit, pemëve dhe perimeve si dhe prodhueseve të verës të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës;
- 1.2. Në sektorin e verës, aplikuesi duhet te jetë i regjistruar në Regjistrin e Prodhuesve të Verës në Kosovë;
- 1.3. Një ndërmarrje mund të përbëhet nga një ose më shumë objekte - njësi lokale të prodhimit;
- 1.4. Përfituesit përfundimtarë nën këtë masë janë fermerët, sipas definicionit nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr.03/L-098 dhe ndërmarrjet tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermave.

2. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë

2.1. Llojet e ndërmarrjeve të përkrahura

- 2.1.1. Mund të përkrahen vetëm ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-5 për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
- 2.1.2. Kategoria e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është e përbërë prej ndërmarrjeve që punësojnë më pak se 249 persona, dhe që kanë një qarkullim vjetor

që nuk i kalon 50 milion euro, dhe bilanci i gjendjes në total që nuk i kalon 43 milionë euro, dhe të jetë i regjistruar sipas legjislacionit kombëtar si përpunues i ushqimit.

## 2.2. Standardet kombëtare:

- 2.2.1. Ndërmarrja e përfituesit duhet të përputhet me standardet minimale kombëtare relevante në fuqi në fund të implementimit të projektit, para pagesës përfundimtare;
- 2.2.2. Lista e plotë dhe e azhurnuar / përditësuar e këtyre standardeve kryesore relevante kombëtare mund të merret ne faqen e internetit të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë.

## 2.3. Qëndrueshmëria ekonomike e ndërmarrjes

- 2.3.1. Aplikuesi duhet të paraqes një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjioni për Zhvillimin e Bujqësisë;
- 2.3.2. Në rastin e ndërtimit ose renovimit, duhet të dorëzojnë edhe projektin teknik te planit të ndërtimit ose renovimit;
- 2.3.3. Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit;
- 2.3.4. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund të kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes;
- 2.3.5. Modeli për planin e biznesit dhe udhëzimet përgatitjen e tij do të jenë pjesë e formularit të aplikimit, të publikuar në faqen e internetit të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë përfituesit potencial.

## 2.4. Kriteret e tjera të pranueshme për përfituesit

- 2.4.1. Në rastin e projekteve të ndërtimit, aplikuesit me rastin e aplikimit, duhet të dorëzojnë:

2.4.1.1. Kopjet e skicave te objektit dhe një paralogaritje të shpenzimeve të materialit dhe punëve të parapara;

2.4.1.2. Kopjen e planit të parcelës ku bëhet investimi;

2.4.1.3. Fletën poseduese për parcelën ku bëhet investimi;

2.4.1.4. Pëlqimin Urbanistik nga organi kompetent (komuna) për leje të ndërtimit;

2.4.1.5. Para kërkesës për pagesë në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të dorëzojë:

2.4.1.5.1. Lejen për ndërtim nga organi kompetent i komunës;

2.4.1.5.2. Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse kërcohët me ligj;

2.4.1.6. Përfituesi duhet të dëshmojë se kanë të paguar obligimet tatumore ndaj ATK;

2.4.1.7. Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përmbyllur në mënyrë të rregullt.

2.4.1.8. Investimet e finançuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2015 nuk duhet të financohen nga Zyra e BE-së apo ndonjë donator tjetër publik.

2.4.1.9. Në rast zbulimit se përfituesi ka tentuar të përfitoj përkrahje nga dy burime publike për investimin e njëjtë, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet të kthej mjetet e marra si dhe do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin

## 2.5. Lista kontrolluese për përzgjedhje mjedisore

2.5.1. Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, para nënshkrimit të kontratave për financim të projekteve për zhvillim rural, projektet e përzgjedhura do t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit mjedisor, sipas Listës Kontrolluese për Përzgjedhje Mjedisore;

2.5.2. Lista kontrolluese do të plotësohet nga AZHB duke dhënë informata shtesë për rubrikën "Karakteristikat specifike" për t'i sqaruar përgjigjet e dhëna;

2.5.3. Nëse një apo më shumë përgjigje në listën kontrolluese është pozitive, atëherë projekti do të ketë ndikim në mjedis, dhe si i tillë kërkon përgatitjen e Planit për Menaxhim Mjedisor (PMM);

2.5.4. Masat zbutëse të parashikuara në listën kontrolluese do të janë pika udhëzuese për përgatitjen e PMM-së;

2.5.5. Procesi i aprovizimit të projektit kërkon që të gjitha masat zbutëse të propozuara të pranohen dhe të miratohen për zbatim nga ana e aplikuesit.

2.5.6. Përgatitja e PMM-së do të jetë obligim i vetë aplikuesit, ndërsa shpenzimet për përgatitjen konsiderohen si shpenzime administrative.

## 3. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

3.1. Te pranueshme janë investimet në sektorin e përpunimit të qumështit, mishit, frutave, perimeve dhe verës si dhe shpenzimet e marketingut për promovimin e tyre;

3.2. Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nën masat e Masës 103 janë:

3.2.1. Përgatitja dhe shtypja e katalogeve, fletëpalosjeve, broshurave, posterave për promovim të produkteve, por jo shpërndarja e tyre;

3.2.2. Prodhimi audio dhe video spoteve promovuese, por jo shpërndarja i tyre mediale.

3.3. Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar ne 5% të investimeve të pranueshme.

## 4. Investimet e pranueshme

### 4.1. Investimet e pranueshme janë:

- 4.1.1. Ndërtimi ose renovimi i objekteve, ndërsa blerja e pronës është e përjashtuar;
- 4.1.2. Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike;
- 4.1.3. Shpenzimet administrative të lidhura me projektin siç janë:
  - 4.1.3.1. shpenzimet për arkitekt, inxhinierë, shpenzimet për këshillime, studime parapake, nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7 %, por jo me shumë se 20.000 € të shpenzimeve të përgjithshme;
  - 4.1.3.2. shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit deri në 3% të kostos së përgjithshme të investimit, por nuk mund të kaloj vlerën mbi 5.000 €;
- 4.1.4. Shpenzimet administrative edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është zgjedhur dhe kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## 5. Shkalla e përkrahjes publike

- 5.1. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 30.000€;
- 5.2. Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 400.000€;
- 5.3. Intensiteti i përkrahjes me para publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme;
- 5.4. Për investimet në trajtimin e mbetjeve rritet intensiteti i përkrahjes publike për 10%, vetëm për pjesën e investimit për këtë qëllim përkrahja publike është 60%;
- 5.5. Pagesa për Masën 103 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në shumë prej 50% bëhet në formë të paradhënis pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin dhe pjesa tjetër e mbetur prej 50% paguhet me të përfunduar të investimit të përgjithshëm.

## 6. Afati i implementimit te projekteve

6.1. Zbatimi i projekteve në Masën 103 realizohet brenda dy viteve buxhetore, përkatësisht deri me 31 dhjetor 2016.

6.2. Pas nënshkrimit të kontratës aplikuesit do të kenë kohë 12 muaj plus dy (2) muaj për zbatimin e projektit. AZHB mund të zgjasë afatin e implementimit për më së shumti 2 muaj, nëse ka arsyë të forta sipas ligjit për këtë, siç është respektimi i periudhave vegjetative te bimët, sjellja e ndonjë makine prej ndonjë vendi të huaj e tjera.

KREU V  
NËNMASAT  
**V.I. SEKTORI I PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT DHE MISHIT**

Neni 13  
Kriteret e pranueshmërisë

**1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë**

1.1. Përfitues të mundshëm janë subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet përpara datës së aplikimit dhe janë të regjistruar ne Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas kategorizimit të ndërmarrjeve për përpunim të ushqimit:

- 2.1.1. Kategoria "A" = shkallë e vogël e rrezikut
- 2.1.2. Kategoria "B" dhe "C" = shkalla e dytë dhe e tretë e rrezikut;
- 2.1.3. Kategoria "D" = shkallë e lartë e rrezikut;
- 2.1.4. Përfituesit e Kategorisë "D" janë të pranueshëm vetëm në rast të rindërtimit për shkak të mbylljes së objektit ekzistues.

**2. Investimet e pranueshme**

**2.1. Investimet e pranueshme për sektorin për përpunimin e qumështit**

- 2.1.1. Investimet në renovim dhe modernizimin e qumështoreve;
- 2.1.2. Investimet në pajisjet për përmirësimin e higjenës dhe cilësisë së prodhimeve (HACCP, ISO 22000);
- 2.1.3. Investimet në pajisjet për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit; menaxhimi i mbetjeve dhe ujit;
- 2.1.4. Investimet në ndërtimin dhe pajisjen e pikave grumbulluese të qumështit dhe në transportin e specializuar;
- 2.1.5. Investimet në pajisje për prodhimet e reja dhe paketimet bashkëkohore;
- 2.1.6. Investimet në teknologjinë për prodhimin e energjisë së ripërtritshme.

**2.2. Investimet e pranueshme për sektorin për përpunimin e mishit**

**2.2.1. Thertoret**

- 2.2.1.1. Rinovimi, zgjerimi dhe modernizimi i thertoreve përfshirë depot ftohëse;
- 2.2.1.2. Rindërtimi, zëvendësimi i thertoreve ekzistuese të kategorisë D;
- 2.2.1.3. Pajisjet dhe objektet për rrjepje, grumbullim dhe regjeje të lëkurave;
- 2.2.1.4. Pajisjet për thertore;

- 2.2.1.5. Ndërtimi, rindërtimi i depove ftohëse;
- 2.2.1.6. Kamionët special për bartjen e kafshëve të gjalla që plotësojnë kërkesat për mirëqenien e kafshëve;
- 2.2.1.7. Stalla për vendosjen e kafshëve para therjes;
- 2.2.1.8. Kamionët frigoriferë për bartjen e mishit;
- 2.2.1.9. Makinat, pajisjet dhe depot për trajtim të mbetjeve dhe nën produkteve;
- 2.2.1.10. Investimet në vendosjen e sistemeve të sigurisë së ushqimit (HACCP, ISO 22000);
- 2.2.1.11. IT, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- 2.2.1.12. Investimet për prodhimin e energjisë se ripërtritshme.

2.2.2. Njësitë për përpunimin e mishit:

- 2.2.2.1. Rinovimi, zgjerimi i objekteve ekzistuese (përfshirë depot ftohëse bashkë me pajisje);
- 2.2.2.2. Rindërtimi, zëvendësimi i objekteve përpunuese ekzistuese të kategorisë D;
- 2.2.2.3. Investimet në pajisje të reja dhe zgjerimi, zëvendësimi i pajisjeve ekzistuese;
- 2.2.2.4. Investimet në implementimin e standardeve te sigurisë;
- 2.2.2.6. Investimet për diversifikim të prodhimeve;
- 2.2.2.7. Investimet në mbrojtjen e mjedisit, pajisjeve për trajtim dhe eliminim të mbetjeve;
- 2.2.2.8. Objektet dhe pajisjet për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët;
- 2.2.2.9. Implementimi i standardeve te sigurisë (HACCP, ISO 22000);
- 2.2.2.10. Dhoma për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;
- 2.2.2.11. Automjetet speciale për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme të shitësit me pakicë;
- 2.2.2.12. Investimet në prodhimin e energjisë se ripërtritshme.

3. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.7 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e përpunimit të qumështit

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Ndërmarrjet që aplikojnë për certifikim me HACCP ose ISO 22.000, duke specifikuar investimet e nevojshme për certifikimin me këto standarde	30
	Aplikuesit ose ndërmarrjet që janë plotësish të certifikuara nga HACCP ose ISO 22000.	20
2.	Investime që shpien në diversifikimin e prodhimit: Futja e të paktën 2 produkteve të reja	10
3.	Shitjet e aplikuesit gjatë vitit 2014 kanë qenë prej 200.000 eurosh deri 2 milionë euro, të vlerësuara nga pasqyra e të ardhurave dorëzuar në ATK.	10

4	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit	10
5.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për $\geq 2$ - $\leq 3$ vjet – 4 pikë Për $> 3$ - $\leq 4$ vjet – 6 pikë Për $> 4$ - $\leq 5$ vjet- 8 pikë Për $> 5$ vjet – 10 pikë	10
6.	Investimet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit – Investimi është bërë për trajtimin e mbeturinave dhe pastrimin e ujit së paku 10% e vlerës së projektit.	10
7.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i referohet prodhimit të energjisë së ripërtërishme	5
8.	Vendet e reja të punës të krijuara, për çdo punëtor të ri të punësuar nga 2 pikë, por jo më shumë se 10 pikë	10
9.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit. <i>(Të dëshmohet me pasqyra financiare nga ATK)</i>	5
Totali		100

3.1.Nëse aplikantet kanë pikë të barabarta, përparësi ka aplikuesi i cili ka aplikuar me herët.

Tabela Nr.8 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e përpunimit te mishit

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Për thertoret (në rast se kemi së paku 50% të mbështetjes publike për thertore)	Ndërmarrjet që aplikojnë për certifikim me HACCP ose ISO 22.000 duke specifikuar investimet e nevojshme për certifikimin me këto standarde
		Aplikuesit ose ndërmarrjet që janë plotësisht të certifikuara me HACCP ose ISO 22000
		Futja e linjave të specializuara për therjen e ripërtypësve të vegjël (dhe e dhi)
2.	Për përpunuesit e mishit (në rast se kemi së paku 50% të mbështetjes publike përpunuesit mishit)	Ndërmarrjet që aplikojnë për certifikim me HACCP ose ISO22000 duke specifikuar investimet e nevojshme për certifikimin me këto standarde
		Aplikuesit ose ndërmarrjet që janë plotësisht të certifikuara me HACCP ose ISO 22000
		Investime që shpien në diversifikimin e prodhimit së paku të dy produkte të reja

3.	Të paktën 30% e lëndës së parë (kafshë ose mish) të përdorur është nga prodhimi vendor. Kjo duhet të dëshmohet përmes kontratave, me fermerët në rast të thertoreve dhe me thertoret në rast të përpunuesve të mishit	10
4.	Aplikuesi nuk ka përsituar grante nga MBPZHR-ja në dy vitet e fundit	10
5.	Investimet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit – Investimi është bërë për trajtimin e mbeturinave dhe pastrimin e ujit së paku 10% e vlerës së projektit.	10
6.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për $\geq 2$ - $\leq 3$ vjet – 4 pikë Për $> 3$ - $\leq 4$ vjet – 6 pikë Për $> 4$ - $\leq 5$ vjet - 8 pikë Për $> 5$ vjet – 10 pikë	10
7.	Krijimi i vendeve të reja të punës, për çdo punëtor të ri nga 2 pikë, por më së shumti 10 pikë	10
8.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit. <i>(Të dëshmohet me pasqyra financiare nga ATK)</i>	5
Totali		100

3.2. Nëse aplikantet kanë pikë të barabarta, përparësi ka aplikuesi i cili ka aplikuar me herët.

## V.II. SEKTORI I PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE

Neni 14  
Kriteret e pranueshmërisë

### 1. Kriteret e veçanta të pranueshmerisë

- 1.1. Përsuituesit e mundshëm janë subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet përpara datës së aplikimit;
- 1.2. Në rast të investimit në qendrat grumbulluese dhe paketuese, kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë së paku 500 ton të prodhimit.

### 2. Investimet e pranueshme

- 2.1. Ndërtimi, renovimi dhe modernizimi i objekteve për përpunim, në përputhje me standarde relevantë të BE-së;
- 2.2. Linjat për konservimin, pasterizimin e frutave dhe perimeve, pajisje për tharje, tunele;

- 2.3. Objektet dhe pajisjet për trajtim pas vjeljes, klasifikimi, sortimi, etiketimi, paketimi dhe deponimi;
- 2.4. Pajisje për paketim, etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara;
- 2.5. Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- 2.6. Pajisje për zinxhirin ftohës, duke përfshirë depo për ftohje dhe ngrirje, tunele të ngrirjes, transporti me frigorifer dhe pajisje të tjera të nevojshme për të siguruar vazhdimesinë në zinxhirin e ftohjes;
- 2.7. Objektet dhe pajisjet për kontrollin e cilësisë, duke përfshirë edhe laboratorët;
- 2.8. Implementimi i standardeve te sigurisë ( HACCP, ISO 22000);
- 2.9. Investimet në mbrojtje te mjedisit, pajisje për trajtim dhe eliminimin e mbeturinave;
- 2.10. Automjetet e specializuara të transportit për lëndë të parë dhe për produkte të gatshme me ftohje dhe pa ftohje;
- 2.11. It harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim.

### 3. Kriteret e përgjedhjes

Tabela Nr. 9 Kriteret e përgjedhjes për sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve

Nr.	Kriteret e përgjedhjes	Pikët
1.	<p>Investime për qendrat e deponimit ose për përpunim: ndërtimi i qendrave të reja / renovimi, zgjerimi i qendrave ekzistuese, duke përfshirë pajisje të ftohjes dhe të ngrirjes, për klasifikim / paketim / etiketim.</p> <p>Kujdes: Në rast të qendrave të deponimit, investimet janë të pranueshme vetëm në objekte me madhësi mbi 500 ton.</p> <p>Piket nga ky kriter merren me kusht që së paku 25% e investimit jane dedikuar investimit të lartëpermendur.</p>	35
2.	Diversifikimi i prodhimit - futja e linjave të reja të përpunimit për produkte të reja në nivelin e ndërmarrjes.	10
3.	<p>Përvoja e ndërmarrjes në treg</p> <p>per <math>\geq 2</math> - <math>\leq 3</math> vite - 4 pikë</p> <p>per <math>&gt; 3</math> - <math>\leq 4</math> vite- 6 pikë</p> <p>per <math>&gt; 4</math> - <math>\leq 5</math> vite- 8 pikë</p> <p>per <math>&gt; 5</math> vite -10 pikë</p>	10
4.	Së paku 80% e prodhimit të mbledhur është nga prodhimi vendor (të deshmohet permes kontratave me fermerët dhe listen e fermereve si dhe sasinë e pranuar	10

5.	Aplikuesi nuk ka perfituar grante nga MBPZHR ne dy vitet e fundit 2013/2014	10
6.	Investimet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit - Investimi është bërë për trajtimin e mbeturinave dhe pastrimin e ujit se paku 10% e vlerës se projektit.	10
7.	Vendet e reja të punës të krijuara, per çdo punetor te ri te punesuar nga 2 pikë, por jo me shume se 10 pikë	10
8.	Aplikuesit kanë pasur afarizem pozitiv gjatë 2 viteve të fundit. (të dëshmohet me pasqyra financiare nga ATK)	5
Totali		100

3.1.Në rast të pikëve të barabarta, përparësi kanë ata që kanë aplikuar me herët.

### V.III. SEKTORI I PRODHIMIT TË VERËS

Neni 15

Kriteret e pranueshmërisë

1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë për prodhim të verës

- 1.1. Përfituesit e mundshëm janë subjektet e regjistruara në Regjistrin e Prodhuesve të Verës;
- 1.2. Më shumë se 50% e lëndës së parë (rrushit) duhet të jetë nga prodhuesit tjere;
- 1.3. Të dëshmoj se ka deklaruar prodhimin vjetor të verës dhe stoqeve të ngelura.

2. Investimet e pranueshme për prodhimin e verës

- 2.1. Ndërtimi / renovimi i objekteve për prodhimin dhe përpunimin e verës;
- 2.2. Pajisjet për përpunimin e verës;
- 2.3. Implementimi i standardeve të sigurisë (HACCP, ISO 22000);

3. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr. 10 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin për përpunimin e verës

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet në Linja të prodhimit për verën në shishe	30

2.	Investimet për objektet apo pajisjet e ruajtjes. Së paku 25 % e investimit është për investimet e përmendura më lartë	20
3.	Marrëdhënet kontraktuese: së paku 80 % e prodhimeve të mbledhura duhet të vijnë nga prodhimet vendore dhe të kenë marrëdhënie kontraktuese me fermerët	15
4.	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit (2013/2014)	10
5.	Përvoja e ndërmarrjes në treg, per $\geq 2 - \leq 3$ vite – 4 Pikë per $> 3 - \leq 4$ vite – 6 Pikë per $> 4 - \leq 5$ vite - 8 Pikë per $> 5$ vite – 10 Pikë	Max. 10
6.	Krijimi i vendet të reja të punës, për çdo punëtor te ri nga 2 pikë, por më së shumti 10 pikë	10
7.	Aplikuesit ka pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit ( <i>Të dëshmohet me pasqyra financiare nga ATK</i> )	5
Totali		100

3.1. Nëse aplikuesit kanë pikë të barabarta, përparësi kane ata që kane aplikuar me herët.

KREU VI  
MASA 302

### DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE

Neni 16  
Përfituesit

#### 1. Përfituesit përfundimtar

- 1.1. Përfitues përfundimtar në këtë masë janë fermerët, si persona fizik dhe juridik sipas definicionit të Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- 1.2. Personat juridik vetëm nëse janë të regjistruar si ndërmarrje mikro ose të vogla sipas Ligjit Nr.03/L-031 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-5 Për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
  - 1.2.1. mikro ndërmarrja duhet të ketë të punësuar deri 9 punëtorë;
  - 1.2.2. ndërmarrja e vogël duhet të ketë të punësuar prej 10 deri 49 punëtorë.

#### 2. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë

- 2.1. Duhet të janë të regjistruar në Registrin e Fermës;

- 2.2. Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë mbi 18 vjeç, por jo më i vjetër se 60 vjet;
- 2.3. Apikuesi duhet të dorëzoj aplikacionin me të gjitha dokumentet e kërkuarë të paraqitura në listën e dokumenteve të kërkuarë në Udhëzuesin për Aplikues sipas këtij udhëzimi;
- 2.4. Investimi duhet të kryhet në zona rurale, sipas përkufizimit të MBPZHR;
- 2.5. Aplikuesi duhet të ketë të kryer së paku shkollën e mesme, në rast të personit juridik kjo vlen për menaxherin;
- 2.6. Aplikuesit duhet të kenë të rregulluara detyrimet tatimore dhe atë: personat fizik, tatimin në pronë kurse personat juridik tatimin në fitim dhe nuk lejohet të kenë obligime financiare ndaj MBPZHR-së;
- 2.7. Përfituesit e projekteve të zhvillimit rural duhet t'i mirëmbajnë investimet e tyre gjatë 5 viteve pas implementimit të investimit, aq sa zgjatë periudha monitoruese. Nëse nuk i mirëmbajnë investimet, përfituesi obligohet të kthej përkrahjen publike;
- 2.8. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 euro, aplikuesi duhet të dorëzoj një projekt-propozim sipas modelit të MBPZHR. Projekt-propozimi për nën masën e turizmit rural është i veçantë;
- 2.9. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 euro, aplikuesit duhet të dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit të MBPZHR. Plani i biznesit për nën masën e turizmit rural është i veçantë;
- 2.10. Modeli për projekt-propozim teknik dhe për planin e biznesit do të publikohet në uebfaqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- 2.11. Të gjithë përfituesit të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe t'i dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga për së paku muajin e fundit para kërkesës për pagesën e fundit;
- 2.12. Përfituesit janë të detyruar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese;
- 2.13. Investimet e financaura nga kjo skemë e granteve nuk bënë të jenë të financaura edhe nga zyra e BE-së apo ndonjë donator tjeter publik.
- 2.14. Në rast zbulimit se përfituesi ka tentuar të përfitoj përkrahje nga dy burime publike, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet të kthej mjetet e marra si dhe do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin;
- 2.15. Përfituesit nuk mund ti jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në mënyrë të rregullt.
- 2.16. Në rast të projekteve të ndërtimit, renovimit, zgjerimit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojë:
- 2.16.1. Kopjen e skicave dhe vlerësimin e shpenzimeve përmateriale dhe përpunën;
  - 2.16.2. Kopjen e planit të parcelës ku do bëhet investimi;
  - 2.16.3. Pëlqimin nga komuniteti (nëse parashihet me Ligj)
  - 2.16.4. Fletën poseduese ose kontratën e noterizuar të qirasë përsë paku 10 vjet për parcelën ose objektin ku do të bëhet ndërtim, rindërtim apo zgjerim kurse për

- projektet që nuk parashohin ndërtim, renovim, zgjerim në pronë të huaj mjafton kontrata e qiramarjes për 5 vjet ;
- 2.17. Në rast të projekteve të ndërtimit, renovimit, zgjerimit, para kërkesës për pagesë në AZHB, përfituesit potencial duhet të dorëzojnë :
- 2.17.1. Lejen ndërtimore nga komuna, në rast të ndërtimeve që janë mbi 10 m<sup>2</sup>;
  - 2.17.2. Vlerësimin e ndikimit në mjedis – nëse kërkohet sipas Ligjit;
- 2.18. Pas nënshkrimit të kontratës me Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, por para fillimit të investimeve, duhet ta marrin pëlgimin nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, nëse objekti është në Listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme te nën masa 302.5.

### 3. Investimet e pranueshme

- 3.1. Për të gjitha nënmasat
- 3.1.1. Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketing nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithmbarshme të investimeve të pranueshme;
  - 3.1.2. Investimet për marketingun e produkteve të prodhua dhe përpunuara janë: materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairet lokale / kombëtare;
  - 3.1.3. Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund të tejkalojnë vlerën prej 3% te shpenzimeve te pranueshme;
  - 3.1.4. Në rast të investimeve që parashohin ndërtim, renovim të objekteve shpenzimet për arkitektë dhe inxhinierë janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

### 4. Aktivitetet e pranueshme

- 4.1. Bletaria prodhimi / përpunimi dhe marketingu imjaltit;
- 4.2. Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre, bimëve mjekuese dhe aromatike, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara;
- 4.3. Përpunimi i prodhimeve bujqësore, të kultivuara dhe marketingu i tyre, perime, fruta, erëza, bimë mjekuese, kërpudha, qumësht, musht, vera, raki nga rrushi dhe nga fruta të tjera, prodhimi i uthullës dhe përpunimi i brumërave;
- 4.4. Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre: përpunimi i tekstilit, lëkurës, leshit, përpunimi i drurit dhe aktivitetet tjera të artit që janë punë artizanale: Punë dore, përgatitja e kostumeve tradicionale, përgatitja – thurja e veshëmbathjeve, xhempera, kapela, shalla, çorape, prodhimi i pëlhirave të thurura dhe të endura, qëndisja, prodhimi - thurja e qilimave dhe sexhadeve, zdrukthëtaria e vogël, përgatitja e bizhuterive të ndryshme dhe aktivitete tjera të artit që janë punë artizanale;
- 4.5. Zhvillimi turizmit rural dhe turizmit në fermë.

## 5. Shkalla e përkrahjës dhe vlera e investimeve

- 5.1. Përkrahja publike është 65% e të gjitha shpenzimeve të pranueshme të investimit;
- 5.2. Vlera minimale e investimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nënmasat e kësaj mase është 5,000 €.
- 5.3. Vlera maksimale e investimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nënmasat, është 30,000 euro, përvèç për nënmasën 302.5 e cila është 50,000 €.

## 6. Afati i implementimit

- 6.1. Afati i implementimit të projekteve të kësaj mase është 120 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në;
- 6.2. Pas periudhës prej 120 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.
- 6.3. AZHB mund të zgjasë afatin e implementimit, nëse ka arsyte të fortat për këtë siç është sjellja e ndonjë makinerie prej ndonjë vendi të huaj.

### KREU VII

### NËNMASAT

#### VII.I. BLETARIA PRODHIMI / PËRPUNIMI DHE MARKETINGU I MJALTIT

Neni 17

Kriteret e pranueshmërisë

#### 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

##### 1.1. Aplikuesi duhet:

- 1.1.1. Të ketë së paku 30 shoqëri – koshere bletësh;
- 1.1.2. Të dëshmojnë përvojë të mjaftueshme bujqësore dhe kompetencë duke plotësuar njëren nga kushtet si në vijim:
  - 1.1.2.1. Fakultetin e Bujqësisë ose shkollën e mesme bujqësore apo
  - 1.1.2.2. Një deklaratë me shkrim ku zotohen që do të vijojnë një kurs trajnimi me kohëzgjatje prej së paku 20 orë, para aplikimit për pagesën përfundimtare.

#### 2. Investimet e pranueshme

##### 2.1. Investimet në koshere, në prodhim të mjaltit, në makineri dhe pajisje përpunim:

- 2.1.1. Rimorkiot e specializuara për bartjen e koshereve, vetëm ata mbi 50 koshere;
- 2.1.2. Investimet në pajisje për nxjerrjen e qumështit të bletës;
- 2.1.3. Investimet në pajisje për kultivimin e mëmave;
- 2.1.4. Ndërtimi, renovimi i dhomës / objektit të mjaltit;

- 2.1.5. Blerja e pajisjeve për mjaltë dhe laboratorëve për analizim të produkteve të bletëve;
- 2.1.6. Blerja e linjave teknologjike për përpunim të mjaltit;
- 2.1.7. Makina paketuese të llojeve të ndryshme.

## 2. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.11 Kriteret e përzgjedhjes për sektor: Bletaria prodhimi / përpunimi dhe marketingu i mjaltit

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Madhësia e fermës / në momentin e aplikimit	Nr. i koshereve	30 - 100
			101-300
			>300
2	Përvojë në bletari dhe prodhim të mjaltit	Vlera e prodhimit të dy viteve të fundit: 1,000 - 3,000 EUR > 3,000 EUR	30
			20
			15
3	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi ekuivalente me orar të plotë - POP )	Krijimi i një vendit te punës POP	10
4	Vendndodhja e fermës /biznesit	Ndodhet në zonë malore	10
		Ndodhet në zona rurale	8
5	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në dy vitet e fundit	10
6	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	2
7	Përgatitja shkollore	Fakulteti i bujqësisë	8
		Shkolla e mesme e bujqësisë	5
8	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	5
9	Bujqësia organike e zhvilluar	Certifikuar për prodhim organik	3
10	Aktivitetet e përbashkëta	Anëtarë i Shoqatës së Bletarëve	2
Totali maksimum			100

3.1. Nëse aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

## VII.II. GRUMBULLIMI DHE PËRPUNIMI I PRODHIMEVE JODRUSORE TË MALIT DHE MARKETINGU I TYRE

Neni 18  
Kriteret e pranueshmërisë

## 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

### 1.1. Aplikuesi duhet të jetë:

- 1.1.1. Person juridik;
- 1.1.2. I licencuar për grumbullimin e bimëve mjekuese dhe aromatike, frutave pyjore dhe kërpudhave nga Departamenti i Pylltarisë i MBPZHR. Ky kriter nuk vlen për aplikuesit që aplikojnë për t'u pajisur me tharëse të prodhimeve jo drusorë të malit.

## 2. Investimet e pranueshme

- 2.1. Ndërtimi / renovimi i objekteve për ruajtjen, përpunimin dhe paketim e bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara;
- 2.2. Blerja e pajisjeve për larje, pastrim, ruajtje, klasifikim dhe përpunim;
- 2.3. Blerja e pajisjeve për ngirje të thellë, për tharje;
- 2.4. Blerja e rafteve për terje;
- 2.5. Pajisje për matje (peshore) paketim dhe etiketim.

## 3. Kriteret e përgjedhjes

Tabela Nr.12 Kriteret e përgjedhjes për sektor: Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Përvoja në aktivitetin e grumbullimit / përpunimit	Vlera e prodhimit të dy viteve të fundit:	
		0 – 1.000 Euro	25
		1001 – 3.000 Euro	30
		> 3.000 Euro	35
2	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekivalenteve me orar të plotë - POP )	Krijimi i një vendi të punës POP (në projekt propozim)	10
3	Vendndodhja e fermës / biznesit	Ndodhet në zonë malore	15
		Ndodhet në zona rurale	10
4	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përsitues i granteve	10

		të MBPZHR në dy vitet e fundit	
5	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	2
6	Përgatitja shkollore	Fakulteti i Bujqësisë / Pylltarisë	8
		Shkolla e mesme e bujqësisë / pylltarisë	5
7	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	10
8	Bujqësia organike e zhvilluar	Certifikuar për prodhim organik	10
Totali maksimum			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

### VII.III. PËRPUNIMI I PRODHIMEVE BUJQËSORE (TË KULTIVUARA) DHE MARKETINGU I TYRE

Neni 19  
Kriteret e pranueshmërisë

#### 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

##### 1.1. Aplikuesi duhet:

- 1.1.1. Në rast te prodhimit të verës dhe rakisë të posedoi me pak se 4 hektarë vreshta;
- 1.1.2. Në rast të përpunimit të qumështit, kapaciteti përpunues nuk duhet të tejkaloj 500 l në ditë.

#### 2. Investimet e pranueshme

- 2.1. Ndërtimi / renovimi i objekteve për prodhim, përpunim dhe ruajtje te prodhimeve;
- 2.2. Ndërtimi renovimi i objektit me enterierit tradicional për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale (të përshkruhet në projekt propozim);
- 2.3. Investimet në makina dhe pajisje përpunuese për pastrim, klasifikim, tharje, grumbullim, ruajtje (frigoriferë me ftohje, me ngrirje, furra për pjekje të brumërave, përzierëse të ndryshme të brumërave, pajisje për prodhimin e rakisë, pajisje për mbushje për raki dhe verëra);
- 2.4. Pajisje për matje, paketim dhe etiketim;
- 2.5. Investimet në pajisjet specifike për përpunim me theks në përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit.

#### 3. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.13 Kriteret e përzgjedhjes për sektor: Përpunimi i prodhimeve bujqësore, të kultivuara dhe marketingu i tyre

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Diversifikimi i aktivitetit në fermë (në projekt propozim ose biznes plan)	Përveç aktivitetit bujqësor aplikuesi merret edhe me ndonjë aktivitet tjeter bujqësor / përpunues	30
2	Përvoja e aplikuesit në aktivitetet e përpunimit (Projekt propozim deklarata + Pasqyra e të ardhurave për persona juridik)	Ka përvojë së paku një vjeçare në përpunimet e listuara	20
		Nuk ka përvojë në përpunimet e listuara	15
3	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekivalenteve me orar të plotë - POP ) (në projekt propozim)	Krijimi i një vendi te ri të punës POP	10
4	Vend ndodhja e investimit	Ndodhet në zona malore	10
		Ndodhet në zona rurale	8
5	Përgatitja shkollore	Fakulteti i bujqësisë	10
		Shkolla e mesme e bujqësisë	8
6	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	10
		Investimi udhëhiqet nga meshkujt ndërmarrës	8
7	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	10
Totali maksimum			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

#### VII.IV. ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE ARTIZANALE DHE MARKETINGU I TYRE

Neni 20  
Kriteret e pranueshmërisë

1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

1.1 Nuk ka kritere te veçanta

## 2. Investimet e pranueshme

- 2.1. Ndërtimi, renovimi i objekteve për zhvillimin e aktiviteteve artizanale si dhe përuajtjen e prodhimeve;
- 2.2. Ndërtim, renovimi i objektit me enterier tradicional për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale (të përshkruhet në projekt propozim);
- 2.3. Investimet në blerjen e pajisje për thurje dhe përendje të pëlburave;
- 2.4. Investimet në blerjen e pajisjeve për punimin e qilimave dhe sixhadeve;
- 2.5. Investimet në blerjen e pajisjeve për përpunimin e lëkurës;
- 2.6. Investimet në blerjen e pajisjeve për përpunimin e drurit dhe aktiviteteve tjera artizanale që janë punë dore;
- 2.7. Investimet në blerjen e pajisjeve për aktiviteteve të tjera artizanale.

## 3. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.14 Kriteret e përzgjedhjes për sektor: Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1.	Apekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	25
		Investimi udhëhiqet nga meshkujt ndërmarrës	15
2.	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit deri në 40 vjet	15
		Ndërmarrësit mbi 40 vjet	10
3.	Madhësia e familjes (nga çertifikata e bashkësisë familjare)	Mbi 8 anëtarë	15
		6 deri 8 anëtarë	10
		Deri në 5 anëtarë	5
4.	Vendndodhja e investimit	Ndodhet në zona malore	15
		Ndodhet në zona rurale	10
5.	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekivalenteve me orar të plotë – POP )	Krijimi i një vendi të punës POP	10
6.	Përvoja e aplikuesit ne aktivitete artizanale*	Ka përvojë në ofrimin e ndonjërit nga artizanatet e listuara	10
		Nuk ka përvojë në ofrimin e shërbimeve te listuara	5

7.	Përgatitja shkollore	Fakulteti	10
		Shkolla mesme	8
	Totali maksimum		100

3.1. Personat juridik e dëshmojnë përvojën me pasqyrën e të ardhurave për vitin paraprak, kurse aplikuesit si persona fizik e përshkruajnë përvojën e tyre në projekt-propozim.

3.2. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

## VII.V. ZHVILLIMI I TURIZMIT RURAL DHE TURIZMIT NË FERMË

Neni 21  
Kriteret e pranueshmërisë

### 1. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

1.1. Aplikuesi duhet të zotohet se objekti që do të rinojohet, adaptohet, zgjerohet duhet të përshtatet stilit përkatës tradicional të zonës rurale dhe të mbështetet me fotografi për ekzistimin e atij objekti me konstruktin tradicional në kohën e aplikimit;

1.2. Përfituesit të cilët investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, pas nënshkrimit të kontratës me Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, por para fillimit të investimeve, marrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Departamenti i Trashëgimisë Kulturore;

1.3. Përfituesi pas nënshkrimit të kontratës duhet ta sjell projektin e dizajnuar nga arkitekti të përshtatur pamjes së objektit siç është paraqitur në fotografi në kohën e aplikimit;

1.4. Në rast të projekteve me bujtinë, në fund të investimit objekti nuk duhet të ketë më pak se 5 shtretër dhe jo më shumë se 15 shtretër;

1.5. Në rast të investimeve në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe bicikletës përrreth objekteve të turizmit rural, me rastin e aplikimit duhet të sjellët pëlqimi i pronarëve të pronave nëpër të cilat kalon ky shteg, i noterizuar nga notari;

1.6. Zotim që në fund të investimit, para kërkesës për pagesë përfituesi e regjistron aktivitetin e tij ekonomik-biznesin në ARBK dhe se do ta punësoj së paku vetveten dhe këtë ta dëshmoj me pagesën e tatimeve dhe kontributeve në të ardhura së paku për një muaj.

### 2. Investimet e pranueshme

- 2.1. Renovimi, adaptimi, zgjerimi objekteve tradicionale për t'i përdorur si bujtina dhe për ofrimin e shërbimeve gastronomike, jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 15 shtretër;
- 2.2. Renovimi i objekteve me pamje tradicionale si mulli, kulla, hamamxhik për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale, për ofrimin e shërbimeve gastronomike tradicionale, për ofrimin e informatave për atë zone rurale;
- 2.3. Investime në ndërtimin e shtigjeve për këmbësor dhe bicikletës për rrith objekteve të turizmit rural;
- 2.4. Blerja e pajisjeve që nevojiten për rregullim, mobilimin e dhomave, kuzhinës, salla ku ofrohet ushqimi, si shtretër, ulëse, tavolina, karrige;
- 2.5. Blerja e pajisjeve që ofrojnë aktivitete për argëtim të fëmijëve, si tobogan, luhatëse, tavolinë pingpong;
- 2.6. Investimet ne krijimin e ueb faqes.

### 3. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.15 Kriteret e përzgjedhjes për sektor: Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmi në fermë

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1.	Lloji i turizmit (të paraqitet në projekt propozim ose biznes plan)	Aplikuesi ka edhe fermë	20
		Aplikuesi nuk ka fermë	15
2.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore	10
		Investimi në zona rurale	5
3.	Lloj i investimeve (Veç për një nënkrifer do të merren pikët)	Investimet në bujtina (me së paku 5 shtretër të ri)	20
		Investimet në ofrimin e shërbimeve gastronomike	15
		Investimet në shtigje për ecje dhe bicikleta	10
4.	Përmirësimi i strukturës së moshës se ndërmarrësve në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	10
5.	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	5
		Investimi udhëhiqet nga meshkujt ndërmarrës	3
6.	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekivalenteve me orar të plotë - POP )	Krijimi i një vendi të punës	5
7.	Përvoja e aplikuesit në turizëm rural	Ka përvojë në ofrimin e ndonjërit nga shërbimet e listuara	5

		Nuk ka përvojë në ofrimin e shërbimeve të listuara	3
8.	Renovimi i ndonjë objekti tradicional që:	Është në listën e tarshigimisë kulturore	10
		Nuk është në listën e trashigimisë kulturore	5
9.	Përgatitja shkollore	Fakultet përkatës	5
		Shkolla e mesme përkatëse	3
10.	Përkrahja nga Grupet Lokale të Veprimit (GLV)	Projekti është rekomanduar nga GLV me strategji të miratuar	10
		Projekti që nuk ka rekomandimin nga GLV	8
Totali maksimum			100

3.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

KREU VIII  
MASA  
UJITJA E TOKAVE BUJQËSORE

Neni 22  
Përfituesi

1. Përfituesi përfundimtar

- 1.1. Përfituesi përfundimtar është fermeri, sipas përkufizimit nga Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe ndërmarrjet tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermave;
- 1.2. Kompanitë Publike Rajonale të Ujitjes;
- 1.3. Komunat;
- 1.4. Shoqatat e Përdorueseve të Ujit.

2. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë

- 2.1. Formulari i aplikimit me projekt propozimin, sipas formës standarde të MBPZHR-së;
- 2.2. Kopja e një llogarie bankare të vlefshme;
- 2.3. Kopjet e planit të tokave bujqësore të përfshira në projekt për ujitje;
- 2.4. Dëshmia që fermerët përfitues nga Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore janë përfshire në projekt;
- 2.5. Kopja e letërnjoftimit të menaxherit dhe të personit të autorizuar - përfaqësues të biznesit;

- 2.6. Përfituesit e projekteve të zhvillimit rural duhet t'i mirëmbajnë investimet e tyre gjatë 5 vjetëve pas implementimit të investimit, aq sa zgjatë periudha monitoruese;
- 2.7. Nëse nuk është bërë mirëmbajtja e investimit gjatë kësaj periudhe atëherë përfituesi obligohet te kthej përkrahjen publike;
- 2.8. Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në mënyrë të rregullt.

2.9. Pas përzgjedhjes së projektit, kërkohet:

- 2.9.1. Kopja mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor nga MMPH – të paraqitet para pagesës së parë - nëse parashihet me ligj;
- 2.9.2. Leja për ndërtim - të paraqitet para pagesës së parë;
- 2.9.3. Të sillet projektit me dizajnin dhe paramasën pasi të nënshkruhet kontrata.

3. Kriteret e veçanta të pranueshmerisë

- 3.1. Projekti teknik i dorëzuar duhet të demonstrojë zvogëlimin e humbjeve të ujit në minimum 10% në rast modernizimi;
- 3.2. Përfituesi duhet të kontraktojë ndërtuesin i cili ka përvojë të mëhershme në ndërtimet relevante që kërkohen dhe i cili do të garantojë për punën e ndërtimit për së paku 3 vjet pas finalizimit të punës;
- 3.3. Ndërtuesi i kontraktuar duhet të dëshmoj pasqyrën financiare të ndërmarrjes se tij për 3 vjetët fundit dhe respektim te legjisacionit nacional te prokurimit;
- 3.4. Përfituesi duhet të dorëzoj deklaratën me shkrim për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit;
- 3.5. Sipërfaqja minimale e projektit nën ujitje duhet të jetë 30 hektarë;
- 3.6. Aplikuesit duhet të dëshmojnë të drejtat pronësore lidhur me investimin e propozuar;
- 3.7. Në rast të aplikimit të komunave dhe kompanive publike te ujitjes, aplikuesit duhet të paraqesin projektin detaj, me paramasë dhe paralogari;
- 3.8. Ne rast te kompanive publike, aplikuesit do të paraqesin vendimin pozitiv të Bordit për miratimin e investimit.

4. Investimet e pranueshme

- 4.1. Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë listuar në Listën e Investimeve të pranueshme për Ujitjen e Tokave Bujqësore të paraqitur në Udhëzuesin për Aplikues;
- 4.2. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 30,000 €, kurse vlera maksimale e projektit është 200,000 €;
- 4.3. Shpenzimet maksimale të pranueshme për tërë periudhën e zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014 - 2020 është 500,000 € për një përfitues.

4.4. Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt - propozimit nuk mund të tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve te pranueshme.

4.5. Në rast të investimeve që parashohin, skica, dizajn të hollësishëm inxhinierik, vlerësim te ndikimit ne mjedis janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

## 5. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela Nr.16 Kriteret e përzgjedhjes për ujitjen e tokave bujqësore

Kriteri	Parametri	Nr. i pikëve
Kostot - efektive për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura	<p>Metoda e kalkulimit:</p> <p>Të gjitha projektet teknike duhet të përfshijnë të dhëna në lidhje me zonën që është rehabilituar / zgjerimi për ujitje dhe kostoja mesatare për ha.</p> <p>Pasi të janë vlerësuar te gjitha projektet, nga projektet e pranueshme do të krijohet një hierarki e kostove / ha, duke filluar nga më e ulëta deri të më e larta.</p> <p>Projekti me koston më të ulët do të marrë numrin maksimal të pikëve, ndërsa projekti me koston më të lartë për hektar do të marrin 0 (zero) pikë.</p> <p>Pjesa tjeter e projekteve të pranueshme do të marrë pikët (me 2 decimale) sipas këtij kriter bazë të kostos së tyre për ha, ndërsa rezultatet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë.</p> <p>Kalkulimi për poentim:</p> $30 * (\frac{C_p - \text{max}C}{\text{min}C - \text{max}C})$ <p>C<sub>p</sub> – kosto për 1 ekstra ose ha të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e vlerësuara.</p> <p>Shpenzime minimale C kosto për 1 ekstra ha të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto minimale për ekstra ose ha të modernizuar të ujitur.</p>	Max. 30

	Maksimale C- kosto për 1 ekstra ose modernizim ha të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto maksimale për ekstra ose modernizim ha të ujitur	
Sipërfaqja e ujitur (hektarë)	30 - 50 ha	10
	50,01 - 75,00 ha	15
	75,01 - 100,00 ha	20
	100,01 – 150,00 ha	25
	Me shume se 150.00 ha	30
Aplikuesi është shoqate për ujitje te tokave bujqësore		10
Numri i fermerëve që përfitojnë nga projekti	Deri në 10	10
	11-20	15
	Më shumë se 20	20
Në fushën e projektit ka prodhues me projekte të financaura në masën 101	Deri në 5	5
	Më shumë se 5	10
Totali		100

5.1. Nëse aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

## 6. Shkalla e përkrahjes publike

6.1. Intensiteti total i përkrahjes publike është 80% të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

6.2. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për një projekt brenda kësaj mase është 30,000 €, kurse vlera maksimale e projektit është 200,000 €.

6.3. Për entitetet private - fermerët dhe ndërmarrjet tjera bujqësore pagesa për masën e uijtjes së tokave bujqësore bëhet në dy (2) këste;

6.3.1. pjesa e parë e përkrahjes publike në shumë prej 50% bëhet në formë të paradhëni pas nënshkrimit të kontratës me përsituesin

6.3.2. pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas përfundimit të investimit të përgjithshëm.

## 7. Afati i implementimit

7.1. Afati i implementimit të projekteve të kësaj mase është 140 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në.

7.2. Pas periudhës prej 140 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e implementimit, nëse ka arsyë të fortë për këtë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## KREU IX PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE

Neni 23  
Implementimi

1. Masat 101, 103, 302 zbatohen nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë.
2. Masa për Ujitjen e tokave Bujqësore zbatohet nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për entitete publike.
3. Divizioni i Prokurimit në MBPZHR zhvillon procedurat e prokurimit publik për Kompanitë Rajonale të Ujites dhe Komunat sipas Ligjt Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 24  
Thirrja për Aplikim

Thirrjen për Aplikim dhe Udhëzuesin për Aplikues e publikon Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë.

Neni 25  
Procedura e shqyrtimit te aplikacioneve

1. Procedura për ofrimin e përkrahjes bëhet sipas Ligjt Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009) sipas këtij udhëzimi administrativ dhe legjislacionit në fuqi.
2. Procedurat për shqyrtimin e aplikacioneve janë:
  - 2.1. Dorëzimi i aplikacioneve nga aplikanti në Zyrët Regionale të MBPZHR - AZHB
  - 2.2. Dorëzim pranimi i aplikacioneve nga Zyrët Regionale të AZHB në AZHB.;
  - 2.3. Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;
  - 2.4. Procesi i vlerësimit të aplikacioneve;
  - 2.5. Kontrolla e parë në teren - vendngjarje;
  - 2.6. Miratimi i projekteve;
  - 2.7. Njoftimi i fermerit me Letër Informuese për pranimin e projektit;
  - 2.8. E drejta e ankesës;
  - 2.9. Vendimi;
  - 2.10. Nënshkrimi i kontratës në mes të përfituesit dhe AZHB-se;
  - 2.11. Koha e kryerjes së investimeve;
  - 2.12. Dorëzimi i kërkesës për pagesë nga përfituesi në Zyret Regionale;

- 2.13. Dorëzimi i kërkesës për pagesë nga Zyret Regionale në AZHB;
  - 2.14. Kontrolla e dytë në terren;
  - 2.15. Masat ndëshkimore në rast të parregullsive gjatë implementimit të granteve;
  - 2.16. Ekzekutimi i pagesës.
3. Zbatimi i procedurave administrative bëhet sipas Ligji Nr.02/L-28 për Procedurat Administrative.
4. Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe prej 3 muajsh nga dorëzimi i aplikacionit e deri tek Letra informuese mbi përkrahjen në pajtim me nenin 81, paragrafi 81.1 të Ligjit Nr. 02/L-28 Për Procedurën Administrative, Ligjet Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe këtij udhëzimi administrativ.

Neni 26  
Dorëzimi i aplikacioneve

1. Formulari i aplikimit merret në Zyret Regionale të MBPZHR - AZHB, në Uebfaqen e MBPZHR dhe të AZHB.
2. Aplikacioni së bashku me dokumentet e kërkuar dorëzohet në 2 kopje brenda afatit sipas shpalljes publike.
3. Aplikacioni dorëzohet personalisht nga aplikuesi ose i autorizuari i tij.  
3.1 Autorizimi duhet të jetë i noterizuar.
4. Aplikuesi ose i Autorizuari me nënshkrimin e tij siguron që të gjitha informatat e dhëna janë të qarta dhe të sakta dhe se ai do të lejojë kryerjen e kontrollit në terren.
5. Aplikuesi pranon një konfirmim për dorëzimin e aplikacionit në të cilin përfshinë datën e saktë, kohën e dorëzimit si dhe numrin e regjistrimit.
6. Zyrtët Regionale të MBPZHR - AZHB pas pranimit të aplikacioneve të kompletuara i dërgojnë në AZHB për shqyrtim.

Neni 27  
Kontrollimi i aplikacioneve në Zyret Regionale

1. Aplikacioni regjistrohet në regjistrin e aplikacionit, duke shënuar datën dhe kohën e dorëzimit.
2. Zyret Regionale përkatëse për bujqësi i kontrollojnë se a është i kompletuar aplikacioni.
3. Dokumentet duhet të jenë të kompletuara - dosja duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e Udhezuesit për Aplikues dhe çdo faqe duhet ta ketë të shkruar numrin, me dorë.
4. Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti të detyrueshëm, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikuesin dhe i tregon për dokumentet që i mungojnë aplikuesit.
5. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të Thirrjes për Aplikim që t'i kompletoset dokumentet.

6. Zyret regionale përkatëse për Bujqësi do t'i dërgojnë aplikacionet e kompletuara në Agjencionin per Zhvillimin e Bujqesisë jo më vonë se 5 ditë pas përmbylljes së afatit të aplikimit.

Neni 28  
Shqyrtimi i aplikacioneve në AZHB

1. Pas pranimit te aplikacioneve nga Zyret Regionale bëhet shqyrtimit administrativ dhe vlerësimi i aplikacioneve - projekteve nga Divizioni i Projekteve të Zhvillimit Rural në AZHB;
  - 1.1 Shqyrtimi administrativ kompletohet brenda 45 ditësh në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.
2. Pas procesit të shqyrtimit administrativ, lënda dërgohet te Divizioni i Kontrollës në AZHB për kontrollë të parë në terren.
3. Në bazë të raportit të kontrollës në terren bëhet vlerësimi i projekteve të zhvillimit rural.
4. Për vlerësimin e projekteve për Masen 103, Agjencioni për Zhvillimin e Bujqesisë duhet të përdorë Listën kontrolluese për Kriteret e pranueshmërisë dhe poentimit.
5. Pas vlerësimit bëhet miratimi:
  - 5.1. Miratohen projektet që kanë përbushur kriteret e pranueshmërise, duke u radhitur në bazë të pikëve të fituara;
  - 5.2. Në listën përfundimtare duhet të perfshihet edhe afati i ankesave;
6. Njoftimi për miratimin e projektit bëhet përmes dërgimit të Letrës Informuese tek përfituesi.
7. Pas Letrës informuese bëhet nënshkrimi i kontratës në mes të përfituesit dhe AZHB, ku përfituesi është i obliguar që të filloj investimet e pranuara.

Neni 29  
Procedura e kërkesës për pagesë

1. Përfituesit që kanë përfunduar investimin dorëzojnë kërkesën për pagesa në Zyret Regionale të AZHB-së.
2. Formulari i kërkesës për pagesë i sigurohet përfituesit nga Zyret Regionale të AZHB.
3. Kërkesa për pagesë me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet personalisht nga përfituesi ose nga personi i autorizuar, siç është përcaktuar në Kontraten për financimin e projekteve mbi përkrahjen.
4. Në mungesë të ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB nuk e pranon Kërkesën për pagesë, por e regjistron kërkesën duke i dhënë përfituesit një kopje dhe duke i treguar dokumentet që i mungojnë kërkesës për pagesë, me informacionin që brenda afatit për aplikim të plotësohet dokumentacioni i kërkuar.
5. Pas përfundimit të afateve të përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij Neni, kërkesa për pagesë refuzohet.

6. Pas zhvillimit të kontolleve administrative të kërkesës për pagesës, lënda dërgohet për kontroll në terren mbi pranueshmërinë e kërkesës për pagesë tek Divizioni i Kontrollës.
7. Në bazë të Vlerësimit të Raportit të Kontrollit dhe faturave të dorëzuara, me kërkesën për pagesë, AZHB lëshon një vendim mbi pagesën brenda 20 ditësh nga dorzimi i kërkesës për pagesë dhe e njofton përfituesin përmes një Letre Informuese.
8. Nëse kërkesa për pagesë nuk iu ka pranuar apo mbështetja publike iu është zvogëluar, në Letër informuese duhet të arsyetohet.
9. Pagesa duhet të kryhet në afat prej 30 ditësh nga lëshimi i vendimit për pranimin e kërkesës për pagesë.
10. Prej ditës së dorezimit të kërkesës për pagesë deri te ekzekutimi i pageses nuk duhet të kalojnë më shumë se 50 ditë, përveç nëse një tejkalim i afatit bëhet për arsyen objektive.

Neni 30  
Dokumentacioni i kërkuar për pagesë

1. Kërkesa për pagesë duhet të përbajë origjinalin e dokumenteve të këruara sipas kërkesës për pagesë.
2. Pagesat mbi shumën 500 € bëhen përmes transferit bankar e cila duhet të vërtetohet me pasqyrat bankare të llogarise rrjedhëse.
3. Për pagesat me vlerë nën 500 € nese pagesa është bërë me para në dorë, duhet të sigurohet fatura dhe kuponi fiskal, kurse nëse pagesa është berë përmes bankës duhet të dorezohet fletepagesa e transferit bankar.

Neni 31  
Shkalla e kontolleve në teren

1. Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë obligohet të verifikojë përbushjen e kritereve për përkrahje përmes kontrollit në terren në shkallë 100%.
2. Pas parashtrimit të Kërkesës për pagesë, Divizioni i Kontrollit i AZHB është i obliguar të verifikojë finalizimin e investimeve me anë të kontrollit në teren.
3. Në bazë të raportit të kontrollit për verifikimin, kërkesës për pagesë dhe dokumentit të bashkangjitur për kryerjen e investimeve, bëhet autorizimi i pagesës.
4. Pas ekzekutimit të pagesës sipas vendimit për përkrahje, zbatohet monitorimi në terren i përfituesve përfundimtar, i cili vazhdon të zbatohet për një periudhë 5 vjeçare.
5. AZHB me vendim të veçantë e cakton komisionin për superkontroll – riverifikim.

Neni 32  
Kontrolla e dytë

Për projekte që kanë të bëjnë me Ndërtimtari dhe Ujite, kontrolla e dytë në terren bëhet nga ekspertë të fushave përkatëse.

Neni 33  
Procedura e ankesave

1. Aplikuesit kanë të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të AZHB.
2. Ankesa duhet të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim drejtar Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, i cili përbëhet nga zyrtarë të AZHB dhe MBPZHR.
3. Aplikuesi mund të paraqes ankesë me shkrim në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
4. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 30 ditësh duhet të jep përgjigje me shkrim, me arsyetim të plotë, drejtar parashtruesit të ankesës.
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave duhet ta vërtetojë ose ta anulojë vendimin e AZHB apo mund të rekomandojë për superkontroll apo riverifikim.
6. Kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, në afat prej 30 ditësh, aplikuesi mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.
7. Në rast të kontestimit të vendimit për pagesë, përfituesi ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e vendimit përkatës. AZHB krijon një Komision të veçantë për rishqyrtimin e kërkesave që ndërlidhen me vendimet për pagesë.

Neni 34  
Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave

1. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave është një trup profesional, administrativ për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen për ankesa, i cili themelohet me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv të AZHB.
2. Komisioni për Shyrtimin e Ankesave përbëhet nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë zyrtarë në AZHB, ndërsa 2 prej të cilëve janë zyrtarë në MBPZHR. Së paku njëri nga të deleguarit e MBPZHR-së duhet të jetë zyrtar nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural (Autoriteti Menaxhues).
3. Anëtarët e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave janë të pavarur për të marrë vendime, konform fakteve dhe gjendjes së verifikuar.
4. Anëtarë i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave obligohet që:
  - 4.1. të zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ;
  - 4.2. të jetë i paanshëm;
  - 4.3. të ketë të drejtën e votës së lirë dhe të pandikuar;
  - 4.4. të marrë pjesë në takimet e Komisionit dhe të nënshkruaj raportet punuese dhe vendimet përkatëse .
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave obligohet që për punën e vetë të hartojë raport me shkrim dhe të informojë organet më të larta të AZHB dhe MBPZHR, si dhe palët e interesit për veprimet e marra, në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës.

Neni 35  
Zbatimi

Obligohet Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural (Autroiteti Menaxhues) në MBPZHR, dhe Drejtoreti përgjegjëse komunale për bujqësi për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 36  
Dispozitat ndëshkimore

1. Mosbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara në nenin 38 Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009) dhe legjislacionit në fuqi.
2. Përveç masës ndëshkimore nga paragrafi 1 i këtij neni, aplikuesi përjashtohen nga çdo përkrahje publike gjatë tri (3) viteve të ardhshme.

KREU X  
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Obligohet AZHB të përgatis dhe të procecojë Thirrjen për Aplikim sipas kriterieve dhe procedurave të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ dhe në Udhëzuesit për Aplikues.

Neni 38

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ është Procedura e Prokurimit.

Neni 39  
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Ministrit.

Memli KRASNIQI  
  
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural  
Prishtinë,  
Data : 02 / 03 / 2015

## PROCEDURAT E PROKURIMIT

Këto procedura zbatohen për të gjitha masat, perveç Masës për Ujitjen e Tokave Bujqësore, kur përfitues janë Kompanitë Rajonale të Ujitjes. Komunat do të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik nga divizion i prokurimit të MBPZHR.

### 1. Dispozitat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha llojet e blerjeve:

- Asnjë nënkontraktues i kontraktuar nga përfituesi nuk mund të kontraktojë ndonjë nënkontraktues tjetër për realizimin e kontratës;
- Blerjet duhet t'i respektojnë investimet që përbushin kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në kuadër të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit psh. për sa i përket kthimit të investimeve, rrjedhës së parasë etj.;
- Procedurat e prokurimit vlejnë vetëm për investimet e pranueshme. Për investimet e papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtpërdrejta, blerjet me së paku 3 oferta dhe përzgjedhje të bazuar në prokurim me shpallje publike (tender i hapur);
- Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varësi të vlerës së blerjeve;
- Është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njëjtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag më të lartë;
- Ofertuesit nuk duhet të jetë në konflikt të interesit;
- Ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave; në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga përfituesi ose nëse dështojnë për të dhënë këtë informacion. Respektimi i rregullave të prokurimit është kusht i detyrueshëm për t'u pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkesës duhet të përbajë dokumentet e pagesave për të dëshmuar plotësimin e procedurave të prokurimit, shih shtojcën 5.

### 2. Kriteret e dhënisë së kontratës

Kontratat duhet të jepen duke u bazuar në këto kritere:

- A. Në rast të furnizimit me mallra - të bazuar në çmimin më të ulët;
- B. Në rastin e ndërtimit (nënkupton rezultatin e ndërtimit ose projektit të inxhinierisë civile që vetveti është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja dizajnimin dhe ekzekutimin) - bazuar në çmimin më të ulët;
- C. Në rast të shërbimeve (studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

Përkufizimi i konfliktit të interesit

- Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet përfituesit dhe furnizuesit (të afërm, apo aksionarë të përbashkët në kompanitë ofertuese) ose në mes te anëtarëve të Komitetit Vlerësues.
- Pronësia e përbashkët (si individë ose si aksionarë) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

### 3. Procedurat e blerjes:

3.1 Blerjet direkte deri në 10 000.00 euro.

Rregullat:

- Përfituesi mund të blejë drejtpërdrejt nga tregu,
- Kostoja e blerjes duhet t'i respektojë pragjet e vendosura në masë,
- Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar në mes të shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës.
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.2 Përgjedhja bazuar në të paktën 3 oferta për blerjet në vlerë prej 10 000.01 euro deri në 60 000.00 euro.

Rregullat:

- Blerjet mund të bëhet vetëm me së paku 3 oferta (kuotim i çmimit),
- Shpenzimet brenda ofertës duhet t'i respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata mes përfituesit dhe furnizuesit,
- Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet të respektojnë dispozitat/detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit;
- Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për oferta, duke respektuar një format standard - shih shtojcën nr. 1 të kontratës;
- Furnizuesit duhet të regjistrojnë ofertën e tyre në regjistrin e hyrje/daljeve.
- Përfituesi duhet të nënshkruajë deklaratën për respektimin e rregullave për shhangjen e konfliktit të interesit - shih shtojcën nr. 2 të kontratës.
- Ofertuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën e tenderuesit të besueshmë - shih shtojcën 3.
- Përfituesi vendos për dhënien e kontratës ofertuesit dhe argumenton arsyen e përgjedhjes;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.3 Prokurimi me shpallje publike (tender i hapur) – për blerjet në vlerë mbi 60 000.00 euro

Rregullat:

- Të gjitha dispozitat nga pika 3.2. duhet të zbatohen;
- Përfituesi duhet ta publikojë interesin e tij për blerjen përmes shpalljes në së paku 1 gazetë të përditshme kombëtare, por në qoftë se vlera është më e lartë se 150 000 €, tenderi duhet të paraqitet edhe në mediet ndërkombëtare. Përveç kësaj, përfituesi ka të drejtë të dërgoj direkt ftesat për furnizuesit e mundshëm për të siguruar një konkurrencë më të mirë në mesin e ofertave, por vetëm në të njëjtën ditë kur është shpallur tenderi;
- Përbajtja e ftesës publike duhet të përfshijë të gjithë informacionin e paraqitur në Shtojcën 1;
- Afati kohor për marrjen e ofertave duhet të jetë të paktën 10 ditë; Përfituesi do të krijojë një komision vlerësimi. Ky komision duhet të ketë një numër tek të anëtarëve, të paktën tre, me të gjitha kapacitetet teknike dhe administrative të nevojshme për të dhënë një opinion të vlefshëm mbi tenderët;
- Komisioni i vlerësimit duhet të përgatit rekomandim me shkrim të argumentuar për dhënien e tenderit.  
Anëtarët e komisionit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë të konfidencialitetit dhe neutralitetit. Shih Shtojcën 4;
- Të gjitha kërkesat për pjesëmarrje dhe tenderët që i plotësojnë kërkesat, duhet të vlerësohen dhe renditen nga komisioni i vlerësimit në bazë të kritereve të përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës të shpallura paraprakisht;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.